



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS LIPJAN

Numri i lëndës: 2023:009150

Datë: 25.01.2023

Numri i dokumentit: 03902802

CN.nr.1/23

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË LIPJAN, në përbërje prej gjyqtares së vetëm Elvira Emini, me bashkëpunëtorin profesional Visar Zeqiri, në procedurën e njohjes së vendimit të gjykatës së huaj, duke vendosur sipas kërkesës së propozueses E. K. nga P., të cilën me autorizim e përfaqëson Valmir Marevci av. në Lipjan, për njohjen e vendimit të gjykatës së huaj, në bazë të nenit 11 të Ligjit mbi Gjykata në Kosove,(Ligji nr. 03/L-199) nenit 3,11,14 dhe 19 të Ligjit mbi procedurën jokontestimore Ligi (Nr 03/L-007), nenit 86, 87 dhe 93 të Ligjit mbi shqyrtimin e konfliktit të Ligjit dhe dispozitave të huaja, me datën **25.01.2023**, bien këtë:

AKTVENDIM

PRANOHET vendimi i Gjykatës së Qarkut në Hildesheim, me numër të lëndës, i datës, i plotfuqishëm me datën 30.06.2014, me të cilin është zgjedhur martesë e lidhur me datë ..., para ofiqarit, në Zyrën e Gjendjes Civile në Lipjan, me numër të referencës dhe numër rendor 543, ndërmjet tani propozueses E. P., i lindur me datën .., në P. dhe propozuesit A. K., i lindur më datën ..., në fshatin V. K. Lipjan.

A r s y e t i m

Propozuesja E. K., përmes të autorizuarit të saj, me datë 12.01.2023, pranë kësaj gjykate ka parashtruar propozimin për njohjen e vendimit të gjykatës së huaj, duke propozuar që gjykata të njej vendimin e Gjykatës së Qarkut në Hildesheim, me numër të lëndës, i datës, i plotfuqishëm me datën 30.06.2014.

Gjykata Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan, shqyrtoi propozimin e propozueses dhe vërtetoi se sipas vendimit të Gjykatës së Qarkut në Hildesheim, me numër të lëndës, i datës ..., i plotfuqishëm me datën 30.06.2014, me të cilin është zgjedhur martesë e lidhur me datë ..., para ofiqarit, në Zyrën e Gjendjes Civile në Lipjan, me numër të referencës ... dhe numër rendor 543, ndërmjet tani propozueses E. P., i lindur me datën, në P. dhe propozuesit A. K., i lindur më datën 22.09.1978, në fshatin V. K. Lipjan.

Në bazë të dokumentacionit të prezantuar nga propozuesi e që tani është pjesë e shkresave të lëndës, Gjykata Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan, konstatoi se vendimi i gjykatës së huaj njohja e të cilit kërkohet nuk është në kundërshtim me dispozitat ligjore që aplikohen në Republikën e Kosovës, prandaj kjo gjykatë vlerësoi se ekziston baza ligjore për njohjen e të njëjtit.

Prandaj në bazë të nenit 11 të Ligjit mbi Gjykatat në Kosovë (Ligji nr. 03/L-199) nenit 3, 11, 14 dhe 19 të Ligjit mbi procedurën jokontestimore Ligii nr. 03/L-007), nenit 86, 87 dhe 93 të Ligjit mbi shqyrtimin e konfliktit të Ligjit dhe dispozitave të huaja, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Numri i lëndës: 2023:009150
Datë: 25.01.2023
Numri i dokumentit: 03902802

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË- DEGA NË LIPJAN,
CN.nr.1/23 me datën 25.01.2023.**

G J Y Q T A R J A
Elvira Emini

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 dite nga dita e dorëzimit të këtij aktvendimi. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj gjykate.